



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____ . ____ . 2020

Lënda: Njoftim për konsultim publik për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 468 datë 23.12.2017 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit” të ndryshuar.

Në mbështetje të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Shërbimeve dhe e Punëve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, përpara dërgimit të projektvendimeve për miratim në Këshillin Bashkiak të akteve zhvillon konsultime.

Në kuadër të këtij procesi, bëjmë me dije se drejtoritë e sipërcituara i prozojnë Këshillit që tarifat për shërbimet funerale për Njësitë Administrative Sukth, Katund i Ri, Ishëm, Manëz, Rrashbull, të aplikohet një ulje minus 50 për qind më pak se tarifat e Qytetit të Durrësit.

Konkretisht, propozojmë që tarifat të jenë sipas tabelës më poshtë e cila do të emërtohet si “Tabela nr. 42 : Tarifa e Shërbimit Funeral për Njësitë Administrative” :

b. NJËSITË ADMINISTRATIVE

Tabela nr. 42: Tarifa e Shërbimit Funeral për Njësitë Administrative

Nr.	Emërtimi	Njësitë Administrative - Sukth, Katund i Ri, Ishëm, Manëz, Ishëm, Rrashbull
		Lekë
1	Tarifa për një shërbim varrim për të rritur	12.000
2	Tarifa për një shërbim varrim për të mitur	8219
3	Tarifa për një shërbim për të mitur (deri 60 cm)	6012
4	Zhvarrime kur varri është i parregulluar	7068
5	Zhvarrime kur varri është i rregulluar	15.618

Për sa më sipër presim çdo koment dhe sugjerim tuajin mbi këtë propozim, të cilat duhet të dërgohen në adresën e e-mail-it luan.dajko@durres.gov.al dhe/ose ardian.iljazaj@durres.gov.al, ose me shkresë pranë protokollit të Bashkisë Durrës, brenda 20 ditëve punë nga publikimi në faqe zyrtare të Bashkisë Durrës.

Duke ju falenderuar për bashëpunimin tuaj !

**Drejtore i Drejtorisë së
Taksave dhe Tarifave Vendore
Luan DAJKO**

**Drejtore i Ndërmarrjes së
Shërbimeve Komunale
Shpëtim Hidri**

**Drejtore i Drejtorisë së
Shërbimeve dhe Punëve Publike
Ardian Iljazaj**